



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gramatikë e Aplikuar

Ngarkesa: (4 kredite, 40 orë mësimore, 30 orë leksione dhe 10 orë seminare)

Viti, semestri kur zhvillohet: Viti I, semestri II.

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Hispanik

Kodi i etikës : Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

(Kjo lëndë shërben për të ndihmuar studentin të familjarizohet me gjuhën, të aftësojë dhe të përmirësojë të shprehurin me gojë ose shkrim, të njohë mirë elementët gramatikorë të nivelit dhe të jetë i aftë t'i përdorë ato saktë. Njohuritë gramatikore ndihmojnë në aftësimin dhe krijimin e autonomisë së të shprehurit. Një ndihmë të madhe në këtë drejtim japin ushtrimet gramatikore të aplikuara individualisht dhe në grup, të cilat ndihmojnë për të praktikuar gjuhën, rrisin vetëvlerësimin e studentëve dhe motivimin e tyre për t'u thelluar më tej në formimin e tyre të plotë. Objektivat kryesore të kësaj lënde janë: zotërimi i elementeve bazë të komunikimit të shkruar dhe të folur, aftësia për t'u zhvilluar dhe përmirësuar duke nisur nga njohuritë e marra paraprakisht, njohja e natyrës së gjuhës dhe funksioneve të saj dhe aftësia e transmetimit të njohurive, ideve dhe informacioneve komplekse në mënyre koherente midis lëndëve të programit mësimor etj.

Konceptet themelore: 1. Mësimi dhe përdorimi në mënyrën e duhur i të gjitha kategorive gramatikore që do të mësohen. 2. Përdorimi i gjuhës si një instrument për të komunikuar duke ju përgjigjur realitetit konkret jashtë auditorit në kontekste të caktuara në gjuhën spanjolle.